



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 19.2.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË LLOJIT MBM NË PORTO-ROMANO, DURRËS, MIRATUAR ME LIGJIN NR.104/2015, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “PORTI MBM (*MULTY BUOY MOORING*)”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr.104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare “PORTI MBM (*MULTY BUOY MOORING*)”, në mbledhjen e datës 19 shkurt 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projekti parashikon realizimin e një sistemi bovash rreth 2 500m nga linja bregdetare në afërsi të Porto Romanos në Durrës. Në këtë largësi vihet re një thellësi rreth 20m, e projektuar për të pritur anije me gjatësi 250m me një zhytje rreth 15 metra.

1. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligj ka si qëllim dhe objekt miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës BOT, të nënshkruar në datën 21.7.2015 dhe të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.104/2015, “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”.

Shoqëria “Porti MBM” paraqiti kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndryshimin e kontratës koncesionare, e cila ka si qëllim garantimin e funksionimit të linjës principiale teknologjike, të paraqitur në kontratën fillestare dhe në kushtet e paparashikuara teknike.

2. Arësyet për ndryshimin e kontratës

Kërkesa e shoqërisë u gjet e arsyetuar nga grupi i punës për shqyrtimin e saj dhe paraqet disa fakte si më poshtë:

- Niveli i tabanit të detit është shumë i ndryshueshëm nga aluvjonet që vijnë nga hidrovori i Porto-Romanos, i cili derdhet në krah të tubacioneve, aluvionet që grumbullohen në anën jugore të argjinaturës së Porto-Romanos, që do të kishte distancë aksiale vetëm 50m, si edhe nga aluvjonet që sjellin rrymat detare. Kjo gjendje e bën linjën e tubave të paqëndrueshme dhe të rrezikuar nga dallgët e detit.
- Shtesa ka qëllim të vetëm garantimin e funksionimit të linjës principale teknologjike, të paraqitur në kontratën fillestare, nga kushtet e paparashikuara teknike që lidhen me marrjen e masave për mbrojtjen nga dinamika e shumëllojtë e fundit të detit në këtë zonë.
- Për të garantuar një qëndrueshmëri të argjinaturës dhe strukturës së tubacioneve ajrore në këtë argjinaturë, është konkluduar se është i nevojshëm një mjet tjetër mbrojtës (dallgëthyes) me të njëjtin profil tërthor e shpatulluar në vendin më të afërt të kodrës përballë në anën jugore të linjës.

3. Ndryshimi i kontratës

Sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet, konkretisht ligjit 125/2013, Kontratat koncesionare mund të ndryshohen, duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë. Kjo mundësi është e parashikuar edhe në kontratë ku ndryshimi mund të bëhet me pëlqimin e palëve dhe duke ndjekur të njëjtën rrugë që ka ndjekur miratimi i kontratës bazë.

Ndryshimet e propozuara nuk ndryshojnë kushtet thelbësore të kësaj kontrate, që janë të përcaktuara në dispozitat e kontratës koncesionare dhe që kanë shërbyer si bazë për garën koncesionare dhe për përzgjedhjen e koncesionarit fitues. Gjithashtu, ndryshimet nuk ndikojnë në pranimin e ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20 000 tonë dhe as nivelin e zhytjes së anijeve që transportojnë hidrokarbure me zhytje mbi 8 metra.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision, deputetët shprehën shqetësim në lidhje me elementë të mjedisit të cilët mund të ndikohen nga zbatimi i këtij projekti, si dhe në lidhje me ecurinë e projektit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Eglantina GJERMENI

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar